



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.1011/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, me pjesëmarrjen e bashkëpuntores profesionale Majlinda Xhema Avdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.... T.... nga L.... rr."G.... T...." nr.35, të cilin me autorizim e përfaqësojnë S... T... dhe I... T... nga L..., kundër të paditurit K... R.... nga L..., të cilën e përfaqëson me autorizim Sh... S... av në L..., me objekt kontesti, pengim posedim, pas përfundimit të seancës kryesore publike, të mbajtur me dt.02.11.2022, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në të njëjten ditë merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET SI E PASAFATSHME** padia me numër C.nr.1011/2020, e paditësit S.... T.... nga L..., kundër të paditurit K... R... nga L..., me objekt kontesti pengim posedim.
- II.** Obligohet I padituri që t'ia paguaj paditësit në emër të shpenzimeve procedural shumën prej 239.-€.

Arsyetim

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur padi, kundër të paditurit K... R... nga Lipjani me objekt kontesti, për pengim posedimi .

Paditësi në padi ka parashtruar se i njëjti është pronar i paluajtshmërive të cilat evidentohen si njësi kadastrale me nr..... ,nr.... dhe nr.....-1 ZK L....

Ka theksuar se paditësi me dt.11.09.2020, ka vrejtë se i padituri ka filluar rrënimin e gardhit në mënyrë të dhunshme dhe të kundërligjme në palujatshmërinë e paditësit, muri –gardh të cilin e e ka vendosur paditësi para 50 viteve në ngastrat e tij kadastrale të lartëcekura, i cili gardh ka shërbyer si megjë. Me këtë rast gjatë ndërtimit të objektit banesor i padituri ka hyrë

në pasurinë e paditësit nga ana e sipërme e parcelës në gjerësi prej ...m nga ka qenë gardhi. Po ashtu, ka shtuar se paditësi me anë të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme me dt.11.09.2020 i është drejtuar Gjykatës për caktimin e masës së përkohshme dhe kthimin e gardhit në gjendjen e mëparshme. Me dt.11.09.2020 pasi paditësi ka bërë rrënimin e gardhit, në oborrin e paditësit kanë hyrë qenë, bagerë dhe njerëz të panjohur me ç'rast paditësin dhe antaret e tjerë të familjes e kanë penguar në posedimin e qetë të palujtshmërisë.

Në seancën e dt.02.11.2022, i autorizuarit i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë padisë dhe kërkespadiës, se ka kërkuar nga fqiu i tij i cili gjatë ndërtimit të objektit ka kaluar në pjesën e tij të palujtshmërisë duke rrënuar murin ndarës i cili ka qenë i vendosur në mes të plaujtshmërisë së tij dhe të fqit të tij N.... S... e të cilën plaujtshmeri e ka blerë i padituri K.... R..... Poashtu i padituri ka refuzuar të marrë pjesë në matjen e palujtshmërisë me ekspert të gjeodezisë, me ç'rast ka penguar vllaun e tij I.. në matjen e palujtshmërisë, eksperti i gjeodezisë A... C.... ka propozuar që kjo çështje të zgjidhet përmes gjykatës.

I autorizuarit i të paditurit në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërsi kërkespadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetimin se paditësi pretendon se me dt.11.09.2020 i padituri me dhunë dhe në mënyrë të kundërligjshme e ka prishur gardhin ndarës në mes të palujtshmerive, ndërsa padin në gjykatë e ka paraqitur me dt.11.12.2020, pas afatit të paraparë ligjor, paditësi me dt.09.10.2020 ka paraqitur propozim për lëshimin e masës së përkohshme të sigurimit për të njëjten ngastër sikur me padi, por e njëjta i është refuzuar me aktvendimin C.nr.871/20 te dt.18.02.2021 I cili aktvendim është vërtetuar me aktvendimin Ac.nr.2586/2021 te dt.26.04.2021.

I autorizuarit i të paditurit në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërsi si në përgjegje në padi, se padia është paraqit jashtë afatit të paraparë ligjor. Ka shtuar se në rast se gjykata e aprovon propozimin e paditësit për dalje në vendshiqim, gjykata me këtë rast duhet vetëm të vertetoj se a ka pengim posedim, pasi që një procedure gjyqësore dhe me ekspertizë gjyqësore nuk është vertetuar që një moment të caktuar është penguar paditësi në pronen e tij.

Gjykata në këtë seancë mori aktvendim lidhur me propozimin e të autorizuarit të të paditurit , se palët do të njoftohen me aktvendim të veçant me shkrim se padia e paditësit është e afatshme apo e pasafatshme.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë dhe thënieve të paraqitura në padi nga paditësi, dhe shqyrtimit në seancën e dt. 02.11.2022, vlerësoj së padia e paraqitur nga ana e paditësit është

e pasafatshme, bazuar në nenin 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (në tekstin e mëtejshëm LPDTS), në të cilin parashihet se **“Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e merr dijeni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit”**, andaj nga këtu rrjedh përfundimi se paditësi ka qenë i njoftuar me pengimin e bërë nga i padituri, qysh nga dt.09.10.2020, si dhe i njëjti me datë 09.11.2020 ka bërë paraqitjen e propozimit për masën e përkohsme pranë kësaj gjykate duke kërkuar nga gjykata që të udhëroj paditësin ta kthejë rrethojën në gjendjen e mëparshme, ndërkaq mbrojtjen gjyqësore lidhur me pengim posedimin e ka kërkuar vetëm pas kalimit të afatit 30 ditor(afati subjektiv), ku i është drejtuar gjykatës me kërkesë për ndaljen e pengimit të posedimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në thëniet e paditësit në padi, provat e bashkangjitura në të, si dhe bazuar në nenin 114 të LPDTS-së, vendosi që padinë e paditësit ta hedhë poshtë si të pasafatshme, pasi që në këtë rast paditësi ka lëshuar afatin subjektiv prej 30 ditësh, që të kërkoj mbrojtje gjyqësore kundër të paditurit.

Vendimin që pala e paditur t’i bartin shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.-€, për 1 seanca për përfaqësim nga avokati shumë prej 135€ , gjithësejt shumë prej 239.00-€
Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ne kuptim të nenit 391.al. 1.pik.f të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1011/20 , dt.02.11.2022

GJYQTARI,

Zenel Tasholli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, prej marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.